

AKT THEMELIMI

“K&K MAMA” SHPK

Sot më datë 24 korrik 2023 (dymijë e njëzet e tre) ortakët:

Z. KLAJDI MAMA, i biri i Avdulit-it, i datëlindjes 11.06.1997 lindur në Tepelenë, shtetas shqiptar madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Në cilësinë e ortakut themelues deklaron me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në: Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar; Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” e ndryshuar; Ligjin nr. 9723 datë, 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” e ndryshuar; Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar; Ligjin nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, krijon shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“K&K MAMA” SHPK**.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria “K&K MAMA” SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i saj në QKB, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.
Shoqëria “K&K MAMA” SHPK është një e tillë kapital i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në “Rruga Nacionale Tepelenë-Përmet, Fshati Dragot, Njësia Administrative Qendër Tepelenë, Zona Kadastrale 1529, Numër Pasurie 16”.
Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë është

Në fushën e turizmit rural, agrobiznesit, hotelerisë si dhe çdo aktivitet tjeter tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë në përputhje me legjisacionin në fuqi. Prodhim, përpunim, tregtim me shumice dhe/ose pakice të bulmetit dhe nënprodukteve të qumështit. "Ndërtim e menaxhim bujtine, ferma blegtoreale, stane. Kultivim dhe përpunim i produkteve bujqësore, mbarështim i shpendëve, kafshëve dhe përpunim i produkteve blegtoreale, të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të argoturizmit. Shërbim ushqimi, restoran, import-eksport produktesh ushqimore, bujqësore e blegtoreale. Hoteleri-Turizëm".

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

KREU II

KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) lekë dhe është i përberë nga 1,00 (një) kuotë e vetme, vlera nominale e të cilës është 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortaku i vetëm i shoqërisë, z. Klajdi Mama, i cili zotëron kuotën me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqindmijë) lekë, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kuota e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohet nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as kontribute në shërbime.

Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e ortakut. Projekti i transferimit i njoftohet shoqërisë dhe ortakut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.



KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) Pjesëtimin e kuotës;
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- j) Vendos për pagat e punonjësve dhe dhënien e shpërblimeve përkatëse;

Asambleja e Përgjithshme brenda një afati prej gjashtë muajsh duke filluar nga data e mbylljes së viti finanziar, miraton reportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, të hartuara nga administratori/ët.

Neni 9 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendoset nga Asambleja e Përgjithshme. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.


Neni 10 Administrimi

Administratori i shoqërisë është ortaku i vetëm z. Klajdi Mama, i biri i Avdul-it, i datëlindjes 11.06.1997 lindur në Tepelenë, shtetas shqiptar madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Administratori/rët emërohet dhe shkarkohet me vendim të AP.

Neni 11 Kompetencat

Administratori/rët kanë të drejtë e detyrohet të:

- a. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga AP;
- b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;



- d. Përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara AP për miratim;
- e. Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f. Kryen raportime në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj apo të urdhëruara me vendim të Ortakut/ëve të shoqërisë.
- h. Administratori i shoqërisë ka të gjitha kompetencat e tjera të cilat mund ti delegohen atij nga ortakët nëpërmjet prokurës.
- i. Administratori i shoqërisë është z. Klajdi Mama.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Neni 12 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

Neni 13 Prishja e shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse nuk ka veprimtari tregtare për dy vjet edhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar;
- Me vendim të gjykatës;

Neni 14 Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi u hartua ne 4 (katër) kopje me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet nen për nen nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare “K&K MAMA” SHPK, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vodosur nënshkrimin e tij original në çdo fletë, si dhe në faqen e fundit, Emrin dhe nënshkrimin original.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË KLAJDI MAMA